



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.06.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E BUSTIT TË ISH-SEKRETARES SË SHTETIT TË SHBA-SË, MEDLIN OLBRAJT

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e bustit të ish-Sekretares së Shtetit të SHAB-së, Medlin Olbrajt, në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e bustit të ish-Sekretares së Shtetit të SHBA-së, Medlin Olbrajt, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 6205-0, ZK Prishtinë, në pronësi, pronë shoqërore – PSH, Shtëpi e Teknikës Popullore "N. Tesla", DS DOM NARODA.
- III. Ky vendim paraqet bazë për caktimin e lokacionit të këtij busti.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0133292/19, më 10.06.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të ish-Sekretares së Shtetit të SHBA-së, Medlin Olbrajt

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën nr. 772, dt. 02.05.2019, drejtuar Kryetarit të Komunës nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, për vendosjen e bustit të ish-Sekretares së Shtetit të SHBA-së, Medlin Olbrajt.

Në bazë të kësaj kërkesë, në kuadër të shënimit të 20 vjetorit të hyrjes së NATO-së në Kosovë, si iniciativë e katër presidentëve të Republikës së Kosovës, më 10 shtator 2018, në bazë të vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr.02/2019, dt. 08.01.2019, për shpalljen e vitit 2019 si vit i NATO-së në Republikën e Kosovës, kërkohet vendosja e këtij busti në këtë lokacion.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e bustit, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë hapësirë me përmbajtje publike.

Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 6205-0, ZK Prishtinë, në pronësi, pronë shoqërore – PSH, Shtëpi e Teknikës Popullore “N. Tesla”, DS DOM NARODA.

Vendosja e bustit në fjalë është propozuar të bëhet në hapësirën para Pallatit të Rinisë, përkatësisht në afërsi të Shkollës Amerikane të Kosovës (ASK), andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës.


Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset busti është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së tij duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit. Propozohet të vendoset në madhësi, formë dhe material ashtu si është përcaktuar në kërkesën e parashtruar.

Bashkëngjitur:


- Ortofoto e lokacionit,
- Kërkesa nga Zyra e Presidentit.

Ortofoto e lokacionit;





REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PRESEDNIKA

DATE:	2 Maj 2019
REFERENCE:	4/2019
PËR/ZA/TO:	Z. Shpend Ahmeti – Kryetar i Prishtinës
CC:	SH.S.Znj. Atifete Jahjaga, ish Presidente e Republikës së Kosovës- Kryesuese e Këshillit Organizativ për shënimin e 20-vjetorit të hyrjes së NATO-së në Kosovë Z. Agim Kuleta – Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës;
NGA/OD/FROM:	Fehmi Mehmeti – Udhëheqës i Ekip Zbatues të agjendës shtetërore për shënimin e 20-vjetorit të hyrjes së NATO-së në Kosovë 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për aprovimin e hapësirave publike për vendosjen e bustit të Sekretares Albright dhe të Monumentit të Lirisë

I nderuar kryetar Ahmeti,

Në kuadër të Shënimit të 20 Vjetorit të hyrjes së NATO-s në Kosovë si iniciativë e katër presidentëve të Republikës së Kosovës me datë 10 shtator, 2018, në bazë të vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës Nr 03/2019, datë 08.01.2019 për shpalljen e vitit 2019 si vit i NATO-s në Republikën e Kosovës si dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Këshillit Organizativ për Shënimin e 20 Vjetorit të Intervenimit të NATO-s në Kosovë, të udhëhequr nga Ish Presidentja Jahjaga, në emër të Ekipin Zbatues për realizimin e agjendës shtetërore të shënimit të 20 vjetorit të intervenimit të NATO-së në Kosovë, më lejoni t'ju përcjellë kërkesën e Këshillit Organizativ për aprovimin e kërkesave për vendosjen e monumentit të Lirisë dhe të Bustit të Sekretares Albright sipas propozimit në vijim:

-I-

BUSTI I SEKRETARES ALBRIGHT,

Bustë-skulpturë e Sekretares do të punohet si portret (Pjesa e epërme e trupit) e cila do të vendosej mbi një bazë.

Përshkrimi i Bustit i Sekretares ALBRIGHT

- 1- Materiali Bronz,
- 2- Dimensione: deri në 1.2 metra bazamenti, 1 m Busti .
- 3- Tema: Portreti i Sekretares **ALBRIGHT**
- 4- Lokacioni: Sheshi Medlin Albright, para Shkollës Amerikane në Kosovë
- 5- Harta: e Bashkëngjitur

Kërkesat për Komunën: Aprovimi i lokacionit dhe përgatitja e bazamentit në beton si dhe sjellja e rrymës elektrike. (Lidhur me bazamentin e bustit, detajet janë diskutuar me z. Dukagjin)

